



AS MURATI NUK KALON, VAZHDON LOJA E LV-së PËR BLLOKIMIN E INSTITUCIONEVE

FAQE 4-5



Hekuran Murati ka dështuar të zgjidhet kryeparlamentar në seancën konstituive të së premtes, pasi ka marrë vetëm 57 vota. Kundër ish-in 51 dhe gjashtë

abstenuan. Seanca u ndërpre. Kryesuesi Avni Dehari ka thënë se seanca vazhdon më 24 gusht në orën 11:00. LV-ja i fajësoi partitë që mandatin e kaluar ishin në opozitë,

për bllokim të formimit të institucioneve, ndërkohë Partia Demokratike e Kosovës tha se LV-ja e propozoi Muratin me qëllim që ta zvarrisë procesin

AKTUALE



**ZELENSKY THOTË SE RUSIA
PO JEP SINJALE SE NUK DËSHIRON
T'I JAPË FUND LUFTËS** F. 2

**GJERMANIA MBËSHTET
INOACIONIN DHE ZHVILLIMIN
E ITP-së NË PRIZREN** F. 5

**UP-ja VLERËSON ROLIN E SHBA-së
PËR BASHKËPUNIM** F. 5

EKONOMI



**BIE NUMRI I PËRFITUESVE NGA
NDIHMA SOCIALE** F. 7

**STRATEGJI TË SUKSESSHME
PËR RITJEN E TURIZMIT,
INOACIONET QË PO TËRHEQIN
VIZITORËT NË EVROPË** F. 7

SPORT



**SUPERLIGA RIKTHEHET ME DUELE
INTERESANTE** F. 10

POLITIKA NGEC, MUNDËSITË IKIN

F. 3



ADMINISTRATA E TRUMPIT PO RISHIKON 55 MILIONË TË HUAJT ME VIZA AMERIKANE

F. 2



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Administrata e Trumpit po rishikon 55 milionë të huajt me viza amerikane

UASHINGTON, 22 GUSHT - Administrata amerikane më 22 gusht njoftoi se po kontrollon mbi 55 milionë persona që kanë viza të vlefshme të ShBA-së, për çdo shkelje që mund të çojë në dëbim. Kjo është pjesë e masave gjithnjë e më të ashpra kundër të huajve që kanë leje qëndrimi në Shtetet e Bashkuara. Në një përgjigje me shkrim për “Associated Press”, Departamenti Amerikan i Shtetit bëri me dije se të gjithë personat me viza - përfshirë turistët e huaj - i nënshtrohen kontrollit të vazhdueshëm për të parë nëse kanë bërë diçka që i bën të papërshtatshëm për hyrje ose qëndrim në ShBA. Nëse gjenden të dhëna të tilla, viza do t’u hiqet, ndërsa nëse mbajtësi i vizës ndodhet brenda territorit amerikan, ai ose ajo do të dëbohet, tha DASH-i. Që kur presidenti amerikan, Donald Trump, mori detyrën,

administrata e tij është përqendruar në dëbimin e migrantëve që qëndrojnë ilegalisht në ShBA, por edhe të atyre me viza studentore apo me viza për programe shkëmbimi të studentëve. Mesazhet nga Departamenti i Shtetit tregojnë se procesi i vazhdueshëm i kontrollit, i cili, sipas zyrtarëve, kërkon shumë kohë - është shtuar ndjeshëm. Kjo do të thotë se edhe ata që tashmë kanë leje qëndrimi në ShBA, kjo leje mund t’u hiqet papritur. Sipas të dhënave të Departamentit për Siguri të Brendshme, vitin e kaluar në ShBA kanë qenë 12.8 milionë persona me “green card” dhe 3.6 milionë me viza të përkohshme. Shifra prej 55 milionësh sugjeron se një pjesë e personave nën kontroll mund të ndodhen jashtë ShBA-së me viza turistike, tha Julia Gelatt nga Instituti për Politika të



Migracionit. Ajo vuri në dyshim vlerën e shpenzimit të resurseve për persona që ndoshta nuk do të kthehen më kurrë në ShBA.

DASH-i theksoi se përqendrohet në indikatorë të papërshtatshmërisë, përfshirë qëndrimin përtej afatit të vizës,

aktivitetet kriminale, rrezikun për rendin publik, përfshirjen në aktivitete terroriste apo mbështetjen e organizatave terroriste. “Ne rishikojmë çdo informacion të disponueshëm gjatë procesit të kontrollit, përfshirë të dhëna nga policia, agjencitë e emigracionit ose çdo informacion tjetër që mund të dalë pas lëshimit të vizës dhe që mund të tregojë papërshtatshmëri”, tha Departamenti i Shtetit. Po ashtu, ShBA-ja do të ndalojë lëshimin e vizave të punës për shoferët e kamionëve komercialë, njoftoi më 21 gusht sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, në rrjetin X. “Shtimi i numrit të shoferëve të huaj që drejtojnë kamionë të mëdhenj me rimorkio në autostradat amerikane po rrezikon jetët e qytetarëve amerikanë dhe po dëmton mundësitë e fitimit për kamionistët amerikanë”, shkroi Rubio.

Zelensky thotë se Rusia po jep sinjale se nuk dëshiron t’i japë fund luftës

KIEV, 22 GUSHT - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha se sjellja e Rusisë pas samitit ShBA-Rusi javën e kaluar dhe bisedimeve të nivelit të lartë në Uashington me liderët evropianë është një sinjal se Moska nuk ka ndërmend të negociojë një marrëveshje paqeje për t’i dhënë fund luftës në Ukrainë. “Tani, sinjalet që po vijnë nga Rusia janë thjesht skandaloze”, tha Zelensky mbremjen e 21 gushtit, pasi Rusia përshkallëzoi sulmet ajrore. “Ata po përpiqen t’i shmangen mbajtjes së një takimi. Ata nuk duan ta përfundojnë këtë luftë”. Forcat Ajrore Ukrainase raportuan të enjten se Rusia lëshoi 574 dronë dhe 40 raketa në disa rajone, duke shkaktuar viktima në mesin e civilëve dhe duke dëmtuar rëndë zonat e banuara dhe infrastrukturën. Sipas autoriteteve ukrainase,



sulmi ajror i Rusisë, më i madhi për këtë muaj, ndodhi disa ditë pasi presidenti amerikan Donald Trump priti Zelenskyn dhe udhëheqësit evropianë në përpjekje për të shtyrë përpara negociatat e paqes. Më herët më 21 gusht, Zelensky u bëri thirrje aleatëve

perëndimorë të bien dakord për një plan konkret mbi garancitë e sigurisë brenda 7-10 ditësh. “Duhet të ushtrojmë presion mbi Rusinë që të ndalojë luftimet”, tha Zelensky, duke shtuar se presidenti rus, Vladimir Putin, “e kupton vetëm forcën dhe presionin”.

Në shënjestër të sulmeve ruse ishte edhe një fabrikë e madhe amerikane për prodhimin e pajisjeve elektronike. Guvernatori i rajonit të Zakarpatjës, Myroslav Biletskiy, tha se fabrika është një ndërmarrje civile që prodhon kryesisht pajisje shtëpiake. Ai shtoi se ajo u godit nga dy raketa Kalibr, duke shkakuar një zjarr që u përhap në një sipërfaqe prej 7.000 metrash katrorë. Ndërkaq, drejtori për marrëdhënie me publikun Conor Phillips tha se fabrika Flex Ltd ka pësuar dëme, duke shtuar se në këtë ndërtesë nuk prodhohen pajisje ushtarake, por vetëm prodhime për përdorim civil. Ai shtoi se disa punonjës janë plagosur dhe gjashtë persona janë hospitalizuar. Andy Hunder, presidenti i Dhomës Amerikane të Tregtisë

në Ukrainë, tha se ishte një sulm raketeor rus “me të vërtetë i tmerrshëm” ndaj një prej investimeve më të mëdha amerikane në Ukrainë. “Kjo nuk ishte vetëm një sulm ndaj Ukrainës. Ishte një sulm ndaj biznesit amerikan”, tha Hunder në X. “Rusia jo vetëm që po shkatërron Ukrainën, ajo po shkatërron dhe poshtëron biznesin amerikan”. Ai i bëri thirrje presidentit amerikan, Donald Trump, që të ndihmojë bizneset amerikane dhe t’i “kundërvihet fushatës së shkatërrimit të Vladimir Putinit”. Ndryshe, gjatë bisedimeve në Uashington më 18 gusht palët u pajtuan që të punohet në një plan për garancitë e sigurisë për Ukrainën pasi të përfundojë lufta. Për ofrimin e garancive të sigurisë barrën kryesore pritet të kenë shtetet evropiane, por ato do të mbështeten nga ShBA-ja.

Marrëveshja Ukrainë - Rusi, kryediplomatja e BE-së: Territoret, 'kurth' i Putinit, do të marrë e s'do të japë gjë

BRUKSEL, 22 GUSHT - Kryediplomatja e Bashkimit European, Kaja Kallas, paralajmëron të mos detyrohet Ukraina që t’i lëshojë Rusisë territore paqeje. Kallasi i tha programit Today të BBC-së se koncesionet e territoreve janë në fakt “kurthi

në të cilin Putini dëshiron që të hyjë Perëndimi”. Rajoni i Donbasit në Ukrainën lindore është kontestuar prej kohësh nga Moska, me agresion ushtarak që detyroi 1.5 milion ukrainas të largohen gjatë dekadës së fundit. Kievi vazhdimisht e refuzuar lëshimin e Donbasit

në këmbim të paqes, pavarësisht se Trumpi e sheh si “të domosdoshme” një lëvizje të tillë. Kallas, e cila është vendosur në “listën e të kërkuarve” të Kremlinit ka folur gjithashtu gjatë për nevojën e garancive “të besueshme dhe të forta” të sigurisë për Ukrainën.

Ajo pranoi se nuk kishte shumë “hapa konkretë” për një forcë penguese në këtë fazë të negociatave. “Garancia më e fortë e sigurisë është një ushtri e fuqishme e Ukrainës”, insistoi ajo, duke nënvizuar rëndësinë e vendosjes së garancive që “nuk do të mbeten vetëm në letër”.



POLITIKA NGEÇ, MUNDËSITË IKIN



PRISHTINË, 22 GUSHT - Për të parën e shtetit të Kosovës, Vjosa Osmani, boshllëku institucional në vend nuk është thjesht një krizë procedurale, por një pengesë serioze për projektet strategjike - nisur nga reformat për integrim evropian, deri te marrëveshjet e mbrojtjes dhe ekonomisë me aleatët ndërkombëtarë.

Për Shtetet e Bashkuara, gjithashtu, bllokada rezulton në “mundësi të humbura për Kosovën”. Kuvendi i Kosovës nuk arriti të konstituohej as këtë javë, përkundër aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, që urdhëroi formimin e tij brenda 30 ditësh. Ky afat do të rrjedhë deri më 18 shtator dhe nga ajo që ka deklaruar kryeministri në detyrë, Albin Kurti, pritet janë që ai të respektohet.

Megjithatë, asnjë prej kandidatëve për kryeparlamentar, të propozuar nga partia e tij, Lëvizja Vetëvendosje, nuk mori vota të mjaftueshme në vazhdimet e seancave më 20 dhe 22 gusht. Seanca konstitutive, që ka nisur qysh më 15 prill, por pa epilog për shkak të mosmarrëveshjeve mes partive, do të vazhdojë sërish më 24 gusht. Osmani tha se konstituimi i Kuvendit është “urgjencë shtetërore”.

Pse urgjencë shtetërore?

Këshilltari i saj për medie, Bekim Kupina, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se boshllëku institucional rrezikon “projektet që ndërlidhen me agjendën e reformave për zhvillim dhe integrim evropian, si dhe ato që synojnë përmirësimin e infrastrukturës energjetike dhe zhvillimin ekonomik”. Sipas tij, konstituimi i Kuvendit dhe Qeveria funksionale janë të

domosdoshme edhe për realizimin e marrëveshjeve - përfshirë ato strategjike në fushën e mbrojtjes dhe ekonomisë, të cilat, siç thotë, Osmani i ka diskutuar me administratën e presidentit amerikan, Donald Trump.

“Këto marrëveshje dhe angazhime janë mundësi unike për forcimin e sigurisë së vendit dhe rritjen ekonomike, e që kërkojnë institucione të konsoliduara për t’u zbatuar”, thotë Kupina.

Muajin e kaluar në ShBA Osmani takoi zëvendëssekretarin amerikan të Shtetit, Christopher Landau, dhe zyrtarë të tjerë të lartë, me të cilët tha se ka biseduar për rëndësinë e krijimit të një partneriteti të ri ekonomik në sektorët e energjisë, mbrojtjes dhe teknologjisë informative.

Duke iu përgjigjur pyetjes së Radios Evropa e Lirë se si e sheh zvarritjen e formimit të institucioneve në Kosovë, edhe gjysmë viti pas zgjedhjeve parlamentare, një zëdhënës i Ambasadës amerikane në Prishtinë tha se “Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka lëshuar vendimin e saj” dhe “leadershipi politik duhet të punojë së bashku për të formuar institucione në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese”. “Populli i Kosovës pret që udhëheqësit e tyre ta përmbushin zotimin për të punuar në interesin më të mirë të vendit”, tha zëdhënësi.

“Kjo bllokadë e vazhdueshme politike po rezulton në mundësi të humbura për Kosovën. Është koha që udhëheqja të bëjë prioritete progresin dhe stabilitetin në dobi të të gjithë qytetarëve”, shtoi ai.

“REL”-i iu drejtua me të njëjten pyetje edhe Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, e cila tha se “formimi i shpejtë i Kuvendit dhe

i Qeverisë është thelbësor për Kosovën që të ecë përpara me reformat e rëndësishme në të gjithë sektorët, të cilat do të përmirësojnë cilësinë e jetesës dhe standardin e jetesës së qytetarëve të Kosovës”.

Nga ambasadat e vendeve të QUINT-it u përgjigj edhe ajo e Italisë, e cila shfaqti shpresën që “të gjithë aktorët politikë të punojnë me përgjegjësi për të siguruar konstituimin e Kuvendit me kohë”.

Drejt “anarkisë institucionale”?

Lulzim Peci, nga Instituti Kosovar për Kërkim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) në Prishtinë, paralajmëron se nëse Kuvendi nuk konstituohet brenda afatit 30-ditor të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese, Kosova do të futet “në një terren të panjohur, që nuk i shihet fundi”. “Ky terren e ka emrin ‘anarki institucionale’. Mos të harrojmë që brenda një kohe, ne mund të mos kemi numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese dhe pastaj mbetemi në anarki totale”, thotë Peci për “Radion Evropa e Lirë”.

Me Kushtetutë, Gjykata Kushtetuese duhet t’i ketë nëntë anëtarë, por aktualisht ka vetëm shtatë.

Në shtator i përfundon mandati gjyqtarit Bajram Latifi dhe nëse deri atëherë nuk emërohet një gjyqtar i ri - gjë që kërkon miratimin e Kuvendit - Gjykata mbetet pa kuorum për vendimmarrje.

Peci paralajmëron se një situatë e tillë do të sillte pasoja të rënda për shtetin. “Mund të na çojë në një shtet të kolapsuar. Pasojat nga kjo do të ishin të jashtëzakonshme, si për

procesin demokratik, për marrëdhëniet me partnerët tonë (ndërkombëtarë), për ekonominë... Anarkia institucionale është skenari më i zi që mund ta presë Kosovën”, thotë Peci. Sipas vlerësimit të tij, Kosova sot pasqyron imazhin e një vendi joserioz, ku interesat e ngushta të politikanëve mbizotërojnë interesin shtetëror.

Një qasje e tillë, siç thekson Peci, përbën pengesë serioze për ndërtimin e partneriteteve me vendet perëndimore, të cilat kërkojnë partnerë të përgjegjshëm dhe të aftë për të marrë vendime.

Ai shton se situata aktuale është bërë një rrethanë e rehatshme për partitë politike, të cilat, siç thotë, e shmangin marrjen e përgjegjësi qeverisëse dhe të vendimeve të mëdha që e presin vendin.

Në mesin e këtyre vendimeve, ai përmend zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë (2023) dhe Marrëveshjes së Uashingtonit për normalizim ekonomik me Serbinë (2020).

Ngecje në integrimet evropiane

Augustin Palokaj, gazetar që prej vitesh ndjek nga afër politikën e Bashkimit Evropian, vlerëson se si BE-ja, ashtu edhe bashkësia ndërkombëtare në tërësi, po e trajtojnë krizën institucionale në Kosovë përmes dy qasjeve.

E para është një qasje pasive: BE-ja po qëndron në pritje, duke i lënë politikanët kosovarë të përballen vetë me ngërçin politik që kanë prodhuar përmes kalkulimeve të ngushta dhe mungesës së vullnetit për kompromis.

Qasja e dytë ka karakter më paralajmërues: përmes deklaratave të vazhdueshme, BE-ja kujton pasojat e drejtpërdrejta dhe afatgjata që sjell mungesa e stabilitetit institucional. Sipas Palokajt, pasojat lidhen fillimisht me fondet evropiane.

Komisioni Evropian nuk mund t’ia transferojë Kosovës pagesën e parë prej mbi 80 milionë eurosh nga Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor.

Kjo shumë është paraparë si parafinancim, por për t’u proceduar kërkohet një qeveri funksionale që të propozojë marrëveshjen për kredi dhe mjete, si dhe një kuvend që ta ratifikojë atë. Pa këto institucione, paratë mbeten të bllokuara.

Një tjetër pasojë, sipas Palokajt, lidhet edhe me procesin e anëtarësimit në Këshillin e Evropës.

Pa kuvend të konstituuar dhe qeveri të re, Kosova nuk mund t’i përmbushë kushtet e përcaktuara, ndaj çështja nuk mund të vendoset as në rend të ditës. “Në këto rrethana, kur nuk mund të hyjmë në Këshillin e Evropës, kur nuk mund të marrim pagesa nga Komisioni Evropian, kur ende ndaj Kosovës janë në fuqi masat ndëshkuese [për shkak të tensioneve në veri], nuk mund të pritët që Kosova të avancojë në procesin e marrjes së statusit të kandidatit për anëtarësim në Bashkimin Evropian”, thotë Palokaj për “Radion Evropa e Lirë”.

Nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, Kosova është e vetmja që nuk e ka këtë status. Palokaj nuk pret që BE-ja të ndërhyjë drejtpërdrejt në zgjidhjen e krizës institucionale në Kosovë, ndaj përgjegjësia duket se do të mbetet plotësisht mbi vetë klasën politike të vendit.



AS MURATI NUK KALON, VAZHDON LOJA E LV-së PËR BLLOKIMIN E INSTITUCIONEVE

Hekuran Murati ka dështuar të zgjidhet kryeparlamentar në seancën konstituive të së premtes, pasi ka marrë vetëm 57 vota. Kundër ishin 51 dhe gjashtë abstenuan. Seanca u ndërpre. Kryesuesi Avni Dehari ka thënë se seanca vazhdon më 24 gusht në orën 11:00. LV-ja i fajësoi partitë që mandatin e kaluar ishin në opozitë, për bllokim të formimit të institucioneve, ndërkaq Partia Demokratike e Kosovës tha se LV-ja e propozoi Muratin me qëllim që ta zvarrisë procesin

PRISHTINË, 22 GUSHT - Partia fituese e zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje, propozoi në seancës e së premtes Hekuran Muratin për pozitën e kryeparlamentarit, propozim që mori mbështetjen e 57 deputetëve, 51 ishin kundër dhe gjashtë abstenuan. LV-ja i fajësoi partitë që mandatin e kaluar ishin në opozitë, për bllokim të formimit të institucioneve, ndërkaq Partia Demokratike e Kosovës tha se LV-ja e propozoi Muratin me qëllim që ta zvarrisë procesin. Para seancës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës propozoi që partitë të konsultohen paraprakisht para se të hidhet

një emër për votim. Ndërkaq, nga Lidhja Demokratike insistuan se pa marrëveshje politike nuk mund të zgjidhet ngërçi politik. Pas seancës, Albulena Haxhiu nga LV-ja tha se për kandidatin e ri do të dihet gjatë seancës së radhës, që do të mbahet më 24 gusht në orën 11:00.

Gërvalla: PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja kanë vendosur ta bllokojnë krijimin e institucioneve

Deputetja Donika Gërvalla nga Guxo - pjesë e koalicionit

parazgjedhor me LV-në - tha se dështimi që Hekuran Murati të marrë 61 vota për kryeparlamentar tregon se "s'është problemi tek emrat". Ajo i akuzoi partitë politike që mandatin e kaluar ishin në opozitë se "kanë vendosur të bllokojnë dhe të shohim se deri ku mund ta çojmë bllokadën". "Bllokimi nuk lidhet me emra të përveçëm, thjesht lidhet me mosgatishmërinë e opozitës për të shkuar në një fazë të re, të konstituimit të vendit, të formimit të qeverisë", tha ajo. Gjatë paraqitjes për medie ajo foli edhe për Listën Serbe, partinë e serbëve të Kosovës që gëzon mbështetjen e Beogradit. Kjo parti votoi kundër Muratit gjatë seancës së sotme. Sipas Gërvallës, Lista Serbe është "parti që synim ka zhbërjen e Kosovës, një parti që nuk e ka vendin në Kuvend dhe në udhëheqje komunale. Andaj jemi këmbëngulës që certifikimi për zgjedhjet e tetorit nuk duhet të ndodhë dhe nuk duhet lejuar që të ndodhë".

Krasniqi: LV me qëllim propozoi Muratin për ta zvarritur konstituimin

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, tha se PDK-ja nuk votoi për Hekuran Muratin pasi, sipas tij, ky subjekt politik e ka bërë të qartë se nuk voton ministrat e qeverisë së kaluar. Krasniqi tha se Vetëvendosje propozoi emrin e Hekuran Muratit për kryetar të Kuvendit, por në asnjë rast ata që kanë mbajtur pozitën e ministrit në mandatin e kaluar. Duke e quajtur të pakuptimtë insistimin e LV-së për votimin e kandidatëve që kanë qenë ministra, Krasniqi tha se nuk përjashtohen zgjedhjet por, sipas tij, duhet të plotësohen kushtet. "Zgjedhjet do të jenë të

pashmangshme, por mekanizmi për të shkuar në zgjedhje duhet të ekzistojë dhe të përmbushet. Mënyra për të shkuar në zgjedhje është që fillimisht të konstituohet Kuvendi", shtoi Krasniqi.

Haziri: Duhet një marrëveshje politike që të zhblokojë situata

Deputeti i LDK-së, Lufti Haziri, tha se duhet të punohet që të arrihet një marrëveshje politike në mënyrë që të zhblokojë situata e krijuar. Para seancës, ai tha se duhet të arrihet një marrëveshje "që i garanton të propozuarit që mund të zgjidhet". I pyetur për propozimin e AAK-së për një konsultë mes partive politike, Haziri tha se nisma është e mirëpritur, por insistoi se situata nuk zgjidhet pa marrëveshje politike. Partitë politike janë të detyruara të bashkëpunojnë, tha Haziri, duke kujtuar se rezultati zgjedhor nuk i mundëson asnjë partie ta ketë shumicën parlamentare vetëm. "Partia e parë duhet të hulumtojë rrugë, të gjejë rrugë drejt një marrëveshjeje politike", tha ai.

UP-ja vlerëson rolin e ShBA-së për bashkëpunim

Prishtinë, 22 gusht - Rektor i Universitetit të Prishtinës, Arben Hajrullahu, i shoqëruar nga prorektorja për ndërkombëtarizim dhe shkëmbim akademik, Rozafa Basha dhe këshilltarja e tij ligjore, Rina Mehana, priti në një takim njohës zëvendëszyrtaren për marrëdhënie me publikun në ambasadën e ShBA-së, Rebecca Satterfield, e cila

erdhi në Rektoratin e UP-së bashkë me specialisten për arsimin e lartë në këtë ambasadë, Remzije Potokun dhe asistenten e angazhimit publik, Gresë Kocën. Gjatë takimit, zyrtaret e ambasadës amerikane treguan se në kuadër të programit Fulbright në Universitetin e Prishtinës do të vijnë profesorë vizitorë nga Shtetet e Bashkuara të

Amerikës. Rektor i UP-së, Hajrullahu, duke falënderuar zyrtaret e ambasadës për projektet nga të cilat kanë përfituar dhe përfitojnë studentët e profesorët nga Universiteti i Prishtinës, tha se janë shumë të lumtur, plotësisht të hapur dhe të etur për të çuar përpara të gjitha llojet e bashkëpunimit. Nga takimi doli qëndrimi i



përbashkët për forcimin e mes universiteteve dhe dy vazhdueshëm të lidhjeve shteteve mike.

GJERMANIA MBËSHTET INOVACIONIN DHE ZHVILLIMIN E ITP-së NË PRIZREN



PRIZREN, 22 GUSHT - Parku i Inovacionit dhe Trajnimit (ITP) në Prizren po shndërrohet në një qendër rajonale të inovacionit falë bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë. Ky kompleks, i zhvilluar në ish-kampin e KFOR-it, punëson rreth 430 persona dhe strehon 60 ndërmarrje aktive, si dhe mbi 2 000 studentë të regjistruar në universitetin brenda parkut. Sekretari Shtetëror Parlamentar në Ministrinë për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim të Gjermanisë, Johann Saathoff, tha se bashkëpunimi i dy vendeve ka treguar se çfarë është e mundur përmes

politikave të zhvillimit, dhe se synimi është ta zhvillojnë më tej ITP-në si një qendër dinamike rajonale të inovacionit. “Këto iniciativa janë të rëndësishme për forcimin e kapaciteteve lokale dhe përgatitjen e rinisë për tregun e punës. ITP Prizren është një shembull i qartë i bashkëpunimit konkret në mes të Kosovës dhe Gjermanisë”, tha Saathoff. Ai shtoi se mbështetja për inovacionin dhe trajnimin profesional do të ndihmojë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe krijimin e mundësive për të rinjtë në rajon.

Haradinaj kërkon konsultime: Ka shumë kandidatë të LV-së që do të kishim mundur t'i votojmë

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka theksuar se partia e tij do të kërkojë, para nisjes së seancës, konsultë me partitë e përfaqësuara në Kuvend. Sipas Haradinajt, në këtë konsultë duhet të diskutohet për kandidaturat dhe të mos shkohet në seancë pa e ditur paraprakisht emrin e kandidatit që Vetëvendosja do ta propozojë për kryetar të Kuvendit. Haradinaj tha se partia e tij ka edhe emra të tjerë nga Vetëvendosja të cilët do t'i votojnë për kryetar të Kuvendit. “Kemi shumë emra të

tjerë në Vetëvendosje që do t'i votonim”, tha Haradinaj.

Limaj: Nëse LV-ja dëshiron krijimin e institucioneve, i duhet marrëveshje politike

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, tha se është e nevojshme një marrëveshje politike për të dalë nga situata aktuale. “Kontributi më i madh dhe garancia për të ndërtuar institucione është ashtu siç ka ndodhur gjithmonë - kur nuk i keni votat e nevojshme, bëni përpjekje për marrëveshje politike. Një marrëveshje politike e cila siguron shumicën parlamentare, nga e cila del edhe kryetari i Kuvendit, edhe Qeveria e Kosovës”, tha Limaj.

Thirrjet e ndërkombëtarëve për konstituimin e Kuvendit

Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Italia u kanë bërë thirrje deputetëve ta konstituojnë sa më shpejt përbërjen e re parlamentare në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

Nga ambasada amerikane në Prishtinë i kanë thënë “Radios Evropa e Lirë” se kjo bllokadë “po i kushton Kosovës me humbje të mundësive”. “Është koha që udhëheqësia të vendosë përparësi te progresi dhe stabiliteti për të mirën e të gjithë qytetarëve”, thanë nga ambasada amerikane.

BE-ja, ndërsa, i inkurajoi deputetët ta

konstituojnë organin ligjvënës.

Zyra e BE-së në Kosovë njoftoi më herët gjatë javës për REL-in se blloku “po i ndjek me kujdes zhvillimet që lidhen me konstituimin e Kuvendit dhe formimin e qeverisë”.

Ndërkohë, Ambasada e Italisë në Prishtinë kërkoi nga deputetët të bëjnë hapa para për përmbylljen e themelimit të Kuvendit. “Shpresojmë që të gjithë aktorët politikë të punojnë me përgjegjësi për ta siguruar konstituimin e Kuvendit me kohë në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese”, tha Ambasada e Italisë në Kosovë në një përgjigje dërguar REL-it.

Rënie e madhe e numrit të nxënësve shqiptarë në Luginën e Preshevës

Preshevë, 22 gusht - Numri i nxënësve shqiptarë në shkollat fillore të Luginës së Preshevës ka pësuar një rënie të ndjeshme në pesë vitet e fundit.

Sipas kryetarit të Këshillit Kombëtar Shqiptar, Enkel Rexhepi, nga viti shkollor 2020/21 deri në vitin 2025/26, numri i nxënësve është ulur nga 4,059 në vetëm 3,650, që

nënkupton 409 nxënës më pak, ose rreth 10 për qind rënie.

Rexhepi ka theksuar se ky trend është pasojë e emigrimit, natalitetit të ulët, kushteve të vështira ekonomike, mosnjohjes së diplomave dhe pasivizimit të adresave.

Ai ka paralajmëruar se situata po e rrezikon seriozisht të ardhmen e shkollës shqipe në

Luginë të Preshevës. “Ky rrezik që na kanoset, i cili prek drejtpërdrejt brezat e ardhshëm të nxënësve dhe gjeneratat e reja shqiptare në Luginë, duhet të na shtyjë drejt një qasje më të guximshme, më të përbashkët dhe më të vendosur për mbrojtjen dhe zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe”, ka shkruar Rexhepi në “Facebook”.



LISTA SERBE ANKOHET NË PZAP PËR VENDIMIN E KQZ-së

PRISHTINË, 22 GUSHT - Lista Serbe tha se vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për moscertifikimin e saj për zgjedhjet lokale të tetorit është “i paligjshëm dhe diskriminues” i kryeministrit në detyrë të Kosovës, Albin Kurti. Nga ky subjekt thanë se do të dorëzojnë ankesë për këtë vendim.

Lista Serbe është partia më e madhe e serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar.

Kryetari i Listës Serbe, Zllatan Ellek, në një konferencë për medie më 22 gusht, tha se, megjithëse zyra për partitë politike rekomandoi certifikimin, KQZ-ja vendosi që ta refuzonte këtë rekomandim. “Është e qartë se Kurti dhe anëtarë i tij në KQZ, para se gjithash mendoj për Alban Krasniqin, bashkëshortin e [ministres në detyrë të Drejtësisë], Albulena Haxhiut, nuk mund t’ia falin Listës Serbe faktin që ajo nuk u zgjodh në pozitën e kryetares së Kuvendit të Kosovës”, tha ai. “Ky reagim i Albin Kurtit është, para se gjithash, për të fituar pikë të lira politike. Ne do t’i ndërmarrim të gjitha veprimet ligjore që janë të nevojshme, me qëllim që ta sigurojmë certifikimin e të gjithë kandidatëve për kryetarë komunash dhe për asamblistë”, shtoi Ellek. Sipas Ellekut, sa i përket përfaqësimit politik të serbëve në Kosovë, në njërin anë është partia e tij, ndërsa në anën tjetër janë “disa parti kuazi-serbe që i mban Albin Kurti”, duke shtuar se me moscertifikimin e Listës Serbe, Kurti “dëshiron ta ndajë trupin politik serb”.

Igor Simiq nga Lista Serbe tha se ankesa ndaj vendimit të KQZ-së është shkruar dhe pas konferencës për medie do t’i dërgohet Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia. “Bashkë me ankesën do t’i bashkëngjisim të gjitha

dëshmitë që flasin në favor të faktit se kandidatët e Listës Serbe për kryetarë komunash dhe asamblistë i kanë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për t’u vendosur në fletëvotimet në të cilat qytetarët do të votojnë në tetor të këtij viti”, tha Simiq. Simiqi ka thënë se “deklaratat anemike” të bashkësisë ndërkombëtare nuk po japin rezultat, sikurse edhe reagimi i të ngarkuarës me punë të ambasadës amerikane në Prishtinë.

Lidhur me deklaratat e bëra nga Ellek për Alban Krasniqin, ministrja në detyrë e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, i hodhi poshtë pretendimet e kreut të Listës Serbe. “Qëndrimet e LV-së në raport me Listën Serbe janë të qarta. Ne në vazhdimësi e kemi kundërshtuar sepse ajo nuk është parti politike që përfaqëson qytetarët serbë të Kosovës. Vetë fakti sesi është krijuar Lista Serbe nuk është si një subjekt politik që ka rrjedhur nga qytetarët serbë në Kosovë, por si dorë e zgjatur e Serbisë dhe kjo ka ndodhur në procesin e negociatave me Serbinë”, tha Haxhiu.

Prandaj, tha Haxhiu, LV-ja në vazhdimësi e ka kundërshtuar certifikimin e kësaj partie. “Tani radhën e ka PZAP-i. Gjyqtarët e PZAP-it është jashtëzakonisht e rëndësishme të bazohen edhe në dokumentacionet e institucioneve tona të sigurisë sepse as anëtarët tanë në KQZ nuk e kanë refuzuar pa pasur informacione”, theksoi ajo.

Çfarë ndodhi gjatë mbledhjes së KQZ-së?

Gjatë mbledhjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më 21 gusht, anëtarët e Lëvizjes Vetëvendosje votuan kundër certifikimit të Listës Serbe për zgjedhjet lokale të 12 tetorit. Ndërkaq, Partia Demokratike e



Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, abstenuan.

Për certifikimin e Listës Serbe votuan vetëm anëtarja e kësaj partie, Gordana Llaban dhe kryetari i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi.

PZAP-i e kishte rrëzuar një vendim të ngjashëm të KQZ-së për zgjedhjet parlamentare, duke ia mundur Listës Serbe pjesëmarrjen në zgjedhjet e 9 shkurtit.

Zyra e Partive Politike në KQZ - që ka për obligim shqyrtimin e aplikimeve të partive politike dhe kandidatëve të tyre për t’u certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje - rekomandoi certifikimin e Listës Serbe.

Anëtarët e LV-së në KQZ, Sami Kurteshi dhe Alban Krasniqi, ishin të zëshëm kundër certifikimit të Listës Serbe, duke argumentuar se ka eksponentë që janë pjesë edhe e strukturave paralele serbe, por e cilësuan këtë parti edhe si “dorë e zgjatur” e presidentit serb Aleksandar Vuçiq në Kosovë.

Kurteshi tha se “90 për qind të personave që janë në listat e

kandidatëve të Listës Serbe janë të anëtarësuar në institucione paralele serbe në Kosovë”. Ai e kundërshtoi kandidaturën e Sasha Millosheviqit për kryetar të Novobërdës duke thënë se ai ishte emëruar nga qeveria serbe për kryetar të komunës së Gjilanit, komunë kjo paralele serbe.

Millosheviqi ishte emëruar për kryetar të Gjilanit nga qeveria serbe më 27 shkurt 2020, si “kryetar i Organit të Përkohshëm të Komunës së Gjilanit”. Por, Qeveria e Serbisë, më 7 gusht mori mbi 20 vendime kadrovike për emërimin dhe shkarkimin e zyrtarëve të institucioneve, mes tyre edhe disa që kanë qenë në krye të organeve të përkohshme për komunat në Kosovë. Ajo nuk dha arsye për këto shkarkime, në mesin e të cilëve ishin edhe Sasha Millosheiq, Zoran Todiq nga Leposaviqi, Novak Zhiviq i ngarkuar për komunën e Prishtinës, Goran Dançetoviq, kryetar i komunës së Obiliqit, Bozhidar Dejanoviq nga Vitia etj.

Vendimi i KQZ-së u kundërshtua nga Serbia. Ministri i Jashtëm serb, Marko Gjuriq, tha se ky vendim ishte “shembull flagrant i inxhinierisë politike që synon përjashtimin e popullit serb nga jeta demokratike”.

Disa orë para mbajtjes së mbledhjes së KQZ-së të enjten, e ngarkuara me punë në ambasadën amerikane në Prishtinë, Anu Prattipati, ia shprehu kryeministrit në detyrë të Kosovës, Albin Kurti, shqetësimin e Shteteve të Bashkuara nga çdo përpjekje për t’ua kufizuar partive serbe pjesëmarrjen në zgjedhjet lokale të tetorit.

Zyrtarja amerikane tha se është shumë e rëndësishme që serbët e Kosovës të marrin pjesë në zgjedhje, duke shtuar se “jemi të shqetësuar për çdo përpjekje që ua kufizon këtë mundësi”.

Më vonë, zëdhënësi i qeverisë në detyrë, Përparim Kryeziu, tha për Radion Evropë e Lirë se nuk është hera e parë që Kurti diskuton me Prattipatin për këtë çështje, duke shtuar se qëndrimi i Kurtit dhe partisë së tij, LV-së, për Listën Serbe dihet.

Lista Serbe vendosi të garojë në zgjedhjet e sivjetshme lokale, pasi kishte bojkotuar zgjedhjet e kaluara lokale, duke bërë që kryetarët shqiptarë ta merrnin dhe mbanin pushtetin në katër komunat me shumicë serbe në veri të vendit nga maji i vitit 2023. Nëse certifikohet, Lista Serbe pritet t’i rimarrë të gjitha katër komunat veriore: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

Lista Serbe ishte në pushtet në të dhjetë komunat me shumicë serbe në Kosovë deri në nëntor të vitit 2022, kur mori vendim për t’u larguar nga institucionet në veri, për shkak të një kërkesë të Qeverisë së Kosovës për t’i zëvendësuar targat serbe të makinave me ato të Kosovës.

Komandanti i UÇK-së, Fatmir Mehmeti, nderohet nga kryetari Hyseni me titullin “Nderi i Qytetit”

GJILAN, 22 GUSHT - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, së bashku me ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, deputeten Arijeta Rexhepi, bashkëpunëtorë të shumtë dhe përfaqësues të Organizatës së Veteranëve të Luftës, vizituan komandantin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Fatmir Mehmeti.

I pari i Gjilanit, Alban Hyseni, tha se baca Fatmir përfaqëson idealin më të lartë të atdhedashurisë dhe sakrificës. Ai theksoi se në periudhën e luftës Fatmir Mehmeti u kthye nga Gjermania për t’iu bashkuar radhëve të UÇK-së, duke dhënë shembullin më të mirë të përkushtimit ndaj vendit.

Krah tij, në këtë rrugë të shenjtë u bashkua edhe vajza e tij,

deputetja Shqipe Mehmeti-Selimi. “Për kontributin e jashtëzakonshëm dhe figurën e tij të ndritur, e nderuam me titullin ‘Nderi i Qytetit’, si shenjë respekti dhe mirënjohjeje të përhershme”, tha kryetari Hyseni.

Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, tha se nderimi dhe respektimi i veprimtarëve të çështjes kombëtare dhe luftëtarëve të lirisë është vlerësim për të kaluarën e lavdishme të popullit tonë dhe frymëzim për brezat e ardhshëm. “Iu bashkova kryetarit të komunës së Gjilanit, Alban Hysenit dhe përfaqësuesve të Organizatës së Veteranëve të Luftës, në nderimin e bacit Fatmir me titullin ‘Nderi i Qytetit’, tha ministri Maqedonci.



STRATEGJI TË SUKSESSHME PËR RRITJEN E TURIZMIT, INOVACIONET QË PO TËRHEQIN VIZITORËT NË EVROPË

PRISHTINË, 22 GUSHT - Qytetet evropiane janë frymëzuar nga skema e shpërblimit "CopenPay" për sjellje të mirë në Kopenhagë. Dhjetëra destinacione të njohura evropiane kanë vendosur gjoba, taksa dhe kufizime të tjera për udhëtarët gjatë muajve të fundit, në një përpjekje për ta luftuar turizmin e tepruar. Megjithatë, vitin e kaluar Kopenhaga mori një qasje shumë të ndryshme. Qyteti filloi t'i shpërblente turistët që tregojnë sjellje të përgjegjshme dhe të vetëdijshme përmes iniciativës CopenPay, raporton "euronews", transmeton "Telegrafi".

Qëllimi kryesor i kësaj skeme është t'u tregojë udhëtarëve se veprimet për klimën mund të jenë shumë më të lehta sesa mendojnë, në përpjekje për ta promovuar turizmin e qëndrueshëm.

Iniciativat përfshijnë ofrimin e qiradhënieve falas të biçikletave, tureve me varkë dhe drekave për udhëtarët që ndihmojnë kopshtet komunitare, mbledhin mbeturina dhe përdorin transportin publik.

Pas veprimeve të Kopenhagës, qytete dhe destinacione të tjera evropiane si Berlini, Helsinki dhe Bremani kanë shprehur

interesim për ta provuar të njëjtin sistem. "Që nga prezantimi i CopenPay verën e kaluar, kemi pasur një interesim të jashtëzakonshëm nga qytete dhe borde turistike nga Evropa, Azia dhe Amerika e Veriut, të gjithë duke dashur të dinë më shumë rreth CopenPay dhe përvojave tona", tha Søren Tegen Petersen, CEO i Wonderful Copenhagen, në një deklaratë për shtyp. "Deri tani kemi ndarë njohuri mbi CopenPay me më shumë se 100 palë të interesuara", shtoi ai.

Berlini po konsideron të nisë një iniciativë të re vitin e ardhshëm, e cila mund t'i shpërblejë udhëtarët që vijnë me tren, qëndrojnë më gjatë, konsumojnë ushqime bimore dhe marrin pjesë në aktivitete miqësore me mjedisin, me përfitime si zbritje në tarifat e hyrjes në muze, ushqim falas dhe qiradhënie falas të biçikletave. Kjo skemë pritet të ndihmojë në ngushtimin e hendekut midis turistëve që duan të jenë më përgjegjës, por nuk dinë si dhe sjelljes së tyre reale.

Qyteti ka sugjeruar se do të përdorë aplikacione mobile dhe sisteme me pikë për ta thjeshtuar



procesin e shpërblimeve dhe angazhimit si dhe do të bashkëpunojë me bizneset lokale.

Helsinki, gjithashtu, është i interesuar ta ndjekë shembullin e Kopenhagës dhe ta paraqesë versionin e vet të një skeme shpërblimi. Kjo ka të ngjarë të ketë fokus të veçantë në turizmin rigjenerues dhe projektet e restaurimit të Detit Baltik në bashkëpunim me destinacione

të tjera baltike dhe nordike.

Skema do t'i inkurajonte turistët që ta përdorin transportin publik dhe të vozitin biçikleta, me shpërblime si ushqime falas dhe ture me zbritje, ndër përvoja të tjera.

Në mënyrë të ngjashme, një qytet tjetër gjerman, Bremani, ka paraqitur tashmë një fushatë bashkëpunimi me Deutsche Bahn për promovimin e turizmit të qëndrueshëm, me plane për ta përdorur modelin CopenPay për zhvillim të mëtejshëm.

Si pjesë e skemës, mysafirët që vijnë me trend dhe qëndrojnë natën në Bremen, marrin pako të vogla me dhurata dhe kuponë nga bizneset e ndryshme të turizmit. "Fushata u prit shumë mirë nga vizitorët tanë dhe na ka inkurajuar të zgjerojmë më tej konceptin, duke forcuar Bremanin si një destinacion të qëndrueshëm. Për vitin 2026 po planifikojmë një iniciativë edhe më të madhe", tha Oliver Rau, drejtor menaxhues i Bremen Marketing dhe Turizëm, Wirtschaftsförderung Bremen GmbH, në deklaratën për shtyp. Destinacionet e njohura për ski në Alpe, si Via Lattea në Itali dhe Les Gets-Morzine në Francë, po ofrojnë zbritje deri në 25 për qind në qendrat e skijimit këtë vit për vizitorët që vijnë me tren.

Shpërblimi i turistëve për sjellje të

përgjegjshme nuk është një koncept krejt i ri, pasi qytete të tjera si Londra kanë pasur skema të ngjashme lokale për vite me radhë.

Në muajin korrik, i njohur gjerësisht si "Muaji Pa Plastikë", vizitorët dhe banorët në Londër janë shpërblyer me një pije falas për pjesëmarrjen në pastrime.

Në Zvicër, udhëtarët që zgjedhin ta eksplorojnë vendin me transport publik përfitojnë hyrje falas në mbi 500 muze me Swiss Travel Pass, si dhe deri në 50 për qind zbritje në shumicën e hekurudhave malore. Wild Sweden, një kompani pushimesh, gjithashtu ofron qasje në spa dhe një vakt falas në Hotel Savoy në Lulea për vizitorët që mbërrijnë në Laplandën suedeze me tren për pushimet e tyre për të parë Dritat e Veriut dhe jetën e egër.

Pranverën e kaluar Normandia paraqiti një tarifë për uljen e karbonit duke ofruar një zbritje prej të paktën 10 për qind të biletave hyrëse në 90 atraksione dhe vende kulturore. Kjo vlen për vizitorët që vijnë në rajonin verior të Francës me autobus, tren ose biçikletë dhe mund të përdoret në kështjella, muze, monumente dhe parqe, si dhe për qiradhënie biçikletash, kanotazh dhe dhoma arratisjeje, ndër aktivitete të tjera.



Bie numri i përfituesve nga ndihma sociale

PRISHTINË, 22 KORRIK - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e mirëqenies sociale për muajin korrik 2025.

Në muajin korrik 2025, krahasuar me muajin korrik 2024, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet invalidore (-22 %); skema për pensionet e Trepçës (-19,8 %); skema e ndihmës sociale (-13,1 %); skema për pensionet familjare (-9,1 %); skema për familjet e

dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-2,2 %); skema e pensioneve kontributpaguesve të moshës (-1,5 %); skema e kompensimeve për personat e verbër (-0,1 %); skema për veteranët e luftës (-0,5 %).

Në muajin korrik 2025, krahasuar me muajin korrik 2024, kishte rritje të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet paraplegjike dhe tetraplegjike (12,1 %); skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me

aftësi të kufizuara (11,7 %); skema e pensioneve bazike të moshës (5,8 %); skema e pensioneve të Forcës së Sigurisë së Kosovë (6,4 %); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (5 %); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (3,7 %); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (2 %).



MISTERI I SHPËRTHIMIT TË GAZSJELLËSIT NORD-STREAM: A E URDHËRUAN SULMIN UKRAINASIT APO ISHTË NJË OPERACION "ME FLAMUR TË RREMË"?



Gushtin e kaluar, hetuesit gjermanë menduan se ishin pranë zgjidhjes. Me urdhër-arrest evropian ata ishin në kërkim të një zhytësi nga Ukraina. Në verën e vitit 2024, Volodymyr Z. u gjurmua më në fund në Poloni. Autoritetet gjermane shpresuan, se kolegët e tyre jashtë vendit do ta arrestonin atë. Por për ditë të tëra, kjo nuk ndodhi. Derisa ky person me ndihmë zyrtare nga Ukraina më në fund arriti të ikte përtej kufirit në vendin e tij të lindjes.

Tani, një vit pas përpjekjes së dështuar në Poloni dhe pothuajse tre vjet pas sulmeve ndaj gazsjellësit Nord Stream, hetuesit më në fund arritën një sukses: Siç njoftoi Prokurori i Përgjithshëm Federal, shtetasi ukrainas Serhii K. u arrestua në provincën italiane të Rimitit gjatë natës nga e mërkura në të enjten. Ky është arrestimi i parë i një të dyshuari në lidhje me një nga aktet më të mëdha të sabotimit në Evropë.

Hetimet e ARD, Süddeutsche Zeitung (SZ) dhe Die Zeit kanë treguar vazhdimisht në vitet e fundit se si hetuesit nga Zyra Federale e Policisë Kriminale (BKA) dhe Policia Federale, të ngarkuar nga Prokurori i Përgjithshëm Federal, po përparonin hap pas hapi në kërkimin e të dyshuarve. Disa javë më parë, autoritetet gjermane kishin shpresa se së shpejti do të kishin sukses.

I arrestuari me gjasë figurë kyçe

Sipas Prokurorit të Përgjithshëm Federal, Serhii K. besohet të jetë një figurë kyçe. Ai dyshohet se është një nga koordinatorët e operacionit në shtator 2022. Sipas urdhrat të arrestit, K., ashtu si Volodymyr Z., thuhet se është pjesë e grupit që dyshohet se vendosi eksplozivin në gazsjellësit Nord Stream 1 dhe Nord Stream 2. Sipas

hulumtimit, hetuesit kanë identifikuar disa të dyshuar, përfshirë civilë dhe individë me trajnim ushtarak.

Sipas hetimeve deri tani dihet, se sulmuesit kanë përdorur në Detin Baltik jahtin gjerman me vela "Andromeda" në shtator 2022. Thuhet se ata e kanë marrë me qira më parë anijen në Rostock duke përdorur dokumente identifikimi të falsifikuara përmes një kompanie në Varshavë. Më pas, zhytësit thuhet se i kanë bashkangjitur eksplozivët me fitil me sahat në tubacionet në shtratin e detit. Më 26 shtator 2022, tre nga katër fijet e dy tubacioneve u shkatërruan përfundimisht.

Suedia dhe Danimarka i kanë mbyllur me kohë hetimet. Prokuroria e Përgjithshme Federale e vazhdoi hetimin nën dyshimin për "shkaktim të qëllimshëm të një shpërthimi" dhe "sabotim antikushetues". Serhii K. akuzohet gjithashtu për "shkatërrim të objekteve", sipas

deklaratës së autoritetit gjerman në Karlsruhe.

Kritikat ndaj Nord-Stream

Për disa vite, një pjesë e madhe e gazit natyror rus për Gjermaninë vinte direkt nëpërmjet Nord Stream 1. Ndërsa qeveria gjermane e kishte promovuar për vite me radhë atë si një projekt të sektorit privat, shumë vende të Evropës Lindore, si dhe Shtetet e Bashkuara dhe Britania e Madhe, e kishin kritikuar ashpër projektin. Ato kishin paralajmëruar për pasojat gjeopolitike të anashkalimit të Evropës Lindore në furnizimin me gaz rus.

Pas fillimit të luftës agresore të Rusisë kundër Ukrainës, Rusia kishte pezulluar tashmë furnizimet nëpërmjet Nord Stream 1 përpara se tubacionet të shkatërroheshin. Për shkak të mosmarrëveshjeve politike, tubacionet e gazsjellësit Nord Stream 2 nuk ishin vënë ende në funksionim.

Arrestimi mund të sjellë prova të reja

Për hetuesit gjermanë, arrestimi mund të sjellë informacione të reja rreth sfondit të vërtetë të sulmit, përfshirë edhe se kush e porosi atë. A e urdhëruan sulmin ukrainasit apo madje vetë qeveria ukrainase? Apo sulmet ndaj Nord Stream janë një operacion "me flamur të rremë" që synon të zhvendosë dyshimet tek Ukraina? Burime gjermane të sigurisë thonë se nuk ka prova që mbështesin supozimin e fundit. Pyetja tjetër që duhet të marrë përgjigje është, edhe nëse grupi i autorëve që kryen shpërthimin vepronte nga Ukraina, a kishte ai një porosi nga shteti dhe mbështetje logjistike? Apo kush veproi këtu? Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky e ka mohuar vazhdimisht përfshirjen e qeverisë së tij në sulme. Arrestimi i fundit mund të hedhë më shumë dritë mbi këtë çështje së shpejti.

Goditje e Ukrainës me dron detar, vriten 5 zhytës 'elitë' rusë

Një dron detar i operuar nga Inteligenca ushtarake e Ukrainës shpërtheu pasi humbi lidhjen me kontrollin qendror dhe u kap nga zhytësit ushtarakë rusë në Gjirin e Novorossiysk, duke vrarë pesë prej tyre, raportoi agjencia më 22 gusht. Sipas agjencisë, gjatë një

operacioni në Detin e Zi, droni detar humbi lidhjen me qendrën e tij të kontrollit për shkak të luftës elektronike dhe filloi të lundronte. Më vonë, komanda ruse thuhet se urdhëroi pesë zhytës zbulimi detar të tërhiqnin dronin detar nga gjiri për inspektim. Inteligenca

ushtarake e Ukrainës HUR i identifikoi ata si anëtarë të komandove rusë – një njësi elitare që merr trajnim të nivelit të lartë, fonde të konsiderueshme dhe pajisje të përparuara. "Ndërsa drejtonte një dron detar ukrainas, ai shpërtheu – shpërthimi rezultoi në

eliminimin e të pesë sabotatorëve nënujorë rusë elitë", thuhej në deklaratë. Koha e saktë e operacionit nuk dihet. Novorossiysk është bërë një port kyç për Flotën Ruse të Detit të Zi, pasi sulmet e suksesshme të Ukrainës në Krimenë e pushtuar e

detyruan Moskën të tërhiqte pjesën më të madhe të forcave të saj detare nga gadishulli. Më 20 gusht, Inteligenca e Ukrainës goditi një anije patrullimi ruse në Detin e Zi pranë qytetit të pushtuar të Portit Zaliznyi në Kherson Oblast, duke vrarë pesë anëtarë të ekuipazhit.

PALESTINA: LUFTËRA, ILUZIONE DHE MUNDËSITË TË HUMBURA. HISTORIA E GJATË E NJË SHTETI ‘FANTAZMË’

Pas Luftës së Dytë Botërore, përpjekja e parë dështoi sepse palestinezët nuk ishin gati. E dyta dështoi në vitin 1993 së bashku me procesin e paqes. Historia e palestinezëve është e mbushur me dhunë, keqkuptime dhe mundësi të humbura. Për më shumë se një shekull, projekti izraelit ka gërryer të drejtat e tyre; për të paktën 80 vjet, palestinezët nuk kanë qenë në gjendje të ndalojnë zgjerimin e shtetit hebre ose të bashkëjetojnë në paqe me të.

Dallimi midis projektit të një shteti hebre dhe një shteti palestinez është se i pari ka qenë gjithmonë i qartë. Madje ka edhe një emër për idenë: Sionizmi. Megjithatë, i dyti u zhvillua ngadalë, duke ndryshuar qëllimet dhe metodat e tij, duke i munguar vizioni dhe lidhshipi. Palestinezët janë përpjekur të ndërtojnë shtetin e tyre përmes terrorizmit, por edhe përmes negociatave, duke u mbështetur në ish-Bashkimin Sovjetik dhe armikun amerikan, me gurët e Intifadës dhe ligjin ndërkombëtar, me deltaplanët vrasës të 7 tetorit dhe rezistencën paqësore të fermerëve të Bregut Perëndimor. Në çdo fazë, gjërat u përkeqësuan. Deri më sot. Përpjekja e Hamasit për të



Ne foto: Tratativat e para ndërmjet arabeve dhe izraelitëve me ndermjetesimin e OKB. 5 korrik 1948

prishur një ekuilibër të padrejtë rrezikon të fshijë ëndrrën (dhe të drejtën) e palestinezëve për një atdhe.

Origjina

Në vitin 1917, kryeministri britanik Balfour i premtoi miliarderit sionist Lord

Rothschild një "shtëpi kombëtare për popullin hebre" në Palestinë. Kur, në vitin 1947, OKB-ja vendosi ta ndante Palestinën në dy shtete, një hebre dhe një arab, palestinezët nuk ishin gati. Pas projektit sionist, emigrantët hebrej kishin ndërtuar institucione funksionale,

ndërsa banorët arabë të zonës jo. Palestinezët shpesh janë kritikuar për refuzimin e shtetit që u ofroi OKB-ja, por në atë kohë, nuk ekzistonte asgjë për t'i përfaqësuar ata. Jordania dhe Egjipti u përgjigjën duke zhvilluar luftë kundër Izraelit dhe duke pushtuar Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës, përkatësisht.

Identiteti Kombëtar


Me nxitjen e Lidhjes Arabe, Organizata për Çlirimin e Palestinës (PLO) u themelua në vitin 1964. Statuti i saj përcakton çlirimin e Palestinës, mohimin e "shtetit sionist" dhe, si metodë, luftën e armatosur. Në vend të "arabëve palestinezë", tani përdorej termi "palestinezë". Në vitin 1967, Egjipti, Jordania dhe Siria u përballën me Izraelin për herë të fundit. Pas disfatës së tyre, vetëm PLO përfaqësonte interesat palestineze dhe merrte fonde nga e gjithë bota arabe. Ajo u bë "organizata terroriste më e pasur në botë", por në vitin 1988 ndryshoi qëndrimin e saj. Së pari, ajo miratoi Rezolutat e OKB-së mbi dy shtetet (Izraelin dhe Palestinën), pastaj në vitin 1993, ajo njohu zyrtarisht "të drejtën e Shtetit të Izraelit për ekzistencë paqësore dhe të sigurt". Megjithatë, statuti nuk u përditësua. Mundësi të Humbura

Marrëveshjet e Oslos të viteve 1993 dhe 1995 më në fund i dhanë jetë administratës civile palestineze në fazën embrionale, asaj që sionistët e kishin organizuar gjysmë shekulli më parë. Në vitin

2012, Palestina u njoh si një "shtet vëzhgues" në OKB. U miratuan rezoluta të shumta të Kombeve të Bashkuara që bënë thirrje për një zgjidhje "me dy shtete", por ato nuk u materializuan kurrë. Një shkollë mendimi akuzon Izraelin sionist të krahut të djathtë për bojkotimin e krijimit të Palestinës. Provë për këtë do të ishte vrasja e Kryeministrit Yitzhak Rabin, i cili kishte dashur paqe, dhe mbështetja e dhënë Hamasit kundër PLO-së. Një shkollë tjetër interpretimi akuzon PLO-në për shmangien e nënshkrimit përfundimtar nga shpresa e zhdukjes së Izraelit ose nga frika se kishte negociuar marrëveshje që ishin shumë të dëmshme.

Udhëheqje e Dyfishtë

Me Marrëveshjet e Oslos, palestinezët u njohën si persona që kishin kontrollin e Bregut Perëndimor dhe Rripit të Gazës, por Izraeli mbajti kontrollin ushtarak të 83% të Bregut Perëndimor, si dhe kontrollin e taksave, energjisë, ujit dhe lëvizjes së njerëzve dhe mallrave. Për më tepër, që nga viti 1967, Izraeli ka favorizuar vendbanimet hebraike në zonat palestineze (të ashtuquajturat "koloni"). E gjithë kjo çoi në shfaqjen e Hamasit, në kundërshtim me vijën tashmë paqësore të vendosur nga OÇP-ja. Lufta e armatosur u rikthye, duke kulmuar me sulmin e 7 tetorit. Edhe një herë, Izraeli, nën sulm, përfitoi. Pas shkatërrimit të Gazës, tani po përpiqet të ndajë Bregun Perëndimor me një koloni të re gjigante. Këto janë hallkat e fundit në një zinxhir.





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Superliga rikthehet me duele interesante

PRISHTINË, 22 GUSHT - Pas startit të mbarë të sezonit, Superliga e Kosovës në futboll rikthehet nesër (e diel) me ndeshjet e javës së dytë, ku priten përballje tejet interesante. Kryendeshja

zhvillohet në stadiumin “Fadil Vokrri”. Prishtina do të përballet me Llapin. Kryeqytetasit, të motivuar pas fitores në hapje të kampionatit, synojnë të vazhdojnë me të njëjtin

ritëm, ndërsa llapjanët vijnë me ambicie të qarta për rezultat pozitiv. Një tjetër duel interesant është ai në mes të Prishtinës së Re dhe Ferizajt, derisa Ballkani dhe Dukagjini do t'i kërkojnë

pikët e para të sezonit kundër Malishevës, respektivisht Gjilanit. Ndërkaq, sfida në mes të Dritës dhe Drenicës është shtyrë për shkak të angazhimit të gjilanasve në garat evropiane.



DRITA, NJË HAP LARG SUKSESIT HISTORIK

PRISHTINË, 22 GUSHT - Kampionia e Kosovës, FC Drita, ka bërë një hap të madh drejt kualifikimit historik në Ligën e Konferencës së UEFA-s. Skuadra gjilanasë të enjten mbrëma para tifozëve të vet në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë ka arritur fitore me rezultat 2:1 ndaj kampionit të Luksemburgut, Differdange 03, në ndeshjen e parë të fazës së “play-off”-it. Golat për Dritën i kanë shënuar Albert Dabiqaj në minutën e 30 dhe Besnik Krasniqi nga penalltia në minutën e 80, ndërsa për mysafirët ka realizuar Andreas Buch në minutën e 65-të. Ndeshja e



kthimit zhvillohet në javën e ardhshme në Luksemburg. Drita do të kërkojë ta kompletojë suksesin dhe ta sigurojë kualifikimin në fazën e ligës, që do të ishte arritja më e madhe në historinë e klubit, njëkohësisht edhe një tjetër sukses për futbollin e Kosovës në arenën evropiane, pas suksesit të arritur dy herë radhazi në këtë ligë nga Ballkani i Suharekës. Në rast të kualifikimit, kundërshtarët e fazës së ardhshme skuadra e drejtuar nga Zekirija Ramadani do t'i mësojë në shortin që do të tërhiqet në selinë e UEFA-s më 29 gusht.

Për këtë fitore presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, i ka uruar lojtarët e Dritës. “I përgëzoj futbollistët për shpirtin luftarak dhe angazhimin gjatë gjithë ndeshjes, stafin teknik, drejtuesit e klubit dhe tifozët 'Intelektualët'. Tani mbeten për t'u menaxhuar me kujdes 90 minutat e ndeshjes së kthimit në Luksemburg, për ta regjistruar suksesin më të madh në historinë e FC Drita, njëherësh për të shënuar një tjetër arritje të futbollit të Kosovës në garat evropiane. Ju priftë e mbara dhe suksese në ndeshjen e kthimit!”, ka thënë Ademi.

BYTYQI TREGON ARSYET E LARGIMIT NGA CSKA-ja

PRISHTINË, 22 GUSHT - Ditë më parë futbollistit Zymer Bytyqi ka shkëputur kontratën me CSKA Sofija pasi javë më parë ishte suspenduar për shkak të thyerjes së rregullores disiplinore. Ai është larguar pas një viti nga CSKA dhe tani është futbollist i lirë, ndërsa nuk ka përjashtuar kthimin në Norvegji, ku edhe ka lindur. “Dua diçka që më bën vërtet të lumtur dhe më frymëzon. Jam i hapur për gjithçka, por nuk do t'u

përgjigjem pyetjeve nëse dua të kthehem të Vikingu në Norvegji”, ka thënë Bytyqi. Bytyqi ka thënë se vendimi për ta ndërprerë kontratën që i skadonte vitin tjetër, u bë me pajtim të të dyja palëve. Ai ka zbuluar se nuk ka pasur asnjë dramë prapa skenave, por thjesht ishte me pëlqim të ndërsjellë, duke shtuar se ishte lojtar i shtrenjtë për CSKA Sofjen. Bytyqi ka konfirmuar se kishte pasur një grindje me

portierin e ekipit, Fyodor Lapukhov, gjatë stërvitjes, por ka thënë se kjo nuk ka të bëjë fare me ndërprerjen e kontratës. “Nuk ishte gjë tjetër, veçse një debat verbal, siç ndodh shpesh në stërvitje”, ka thënë Bytyqi. Sipas tij, qëndrimi në Bullgari nuk kishte shkuar sipas planifikimit pasi kur kishte firmosur kontratën kishte marrë garanci për një projekt ambicioz të klubit. “Kishte, gjithashtu, një ndjesi kaosi në



klub. Më lanë të luaja para se të shërohesha plotësisht nga lëndimi dhe motivimi ishte i ulët. Thjesht, nuk përshtatesha”, ka thënë Bytyqi. Ai ka thënë se nuk e ka problem të gjejë ekip pasi vazhdimisht ka telefonata dhe nuk përjashton asnjë skuadër, pasi është i hapur për të gjitha, përfshirë edhe kthimin në Norvegji. “Po kërkoj një klub dhe një vend ku mund të ndiej përsëri kënaqësi”, ka thënë Bytyqi.

ZHEGROVA REFUZON MARSEILLEN, E PRET JUVENTUSIN



PRISHTINË, 22 GUSHT - Edon Zhegrova, sulmuesi kosovar i Lilleit, ka vendosur ta refuzojë ofertën e Marselës dhe të qëndrojë i fokusuar tek e ardhmja e tij, ndërsa Juventus duket gati t'i përshpejtojë bisedimet me

klubin francez për të realizuar një transferim të madh për krahun sulmues, raporton “Tuttosport”. Zhegrova ka tërhequr vëmendjen e të gjithë drejtuesve të Juventusit të cilët e shohin operacionin si

shumë të favorshëm për raportin cilësi-çmim. Trajneri Igor Tudor e vlerëson talentin e tij dhe aftësinë për të luajtur në role të ndryshme. I lindur në 1999, Edoni mund të veprojë si krah i djathtë apo i majtë

sulmues, por edhe si trekuartista pas një sulmuesi qendror. Ai mund të luajë si e dyta sulmuese në raste emergjente, duke e bërë atë lojtar shumë fleksibël dhe të vlefshëm për skemat taktike të Tudorit.

Ish-basketbollisti i NBA-s bëhet futbollisti më i gjatë në histori

MOSKË, 22 GUSHT - Në një ndërthurje të papritur mes dy botëve sportive, Pavel Podkolzin, ish-lojtar i NBA-s, ka bërë debutimin e tij për Amkal Moscow në Kupën e Rusisë, duke u bërë menjëherë futbollisti më i gjatë në histori. 40-vjeçari rus, i gjatë 2.26 metra,

ka tërhequr vëmendjen e botës për gjatësinë e tij të jashtëzakonshme. Ndërkohë që në basketboll të shohësh lojtarë të gjatë nuk është e pazakontë. Në futboll kjo gjatësi bëhet menjëherë temë diskutimi, sidomos kur dikush kalon nga një sport në tjetrin.

Podkolzin ka luajtur në NBA dhe në NBA Development League, por nuk ka arritur të ndërtojë një karrierë të gjatë në basketboll. Ai është zgjedhur nga Utah Jazz në draftin e vitit 2004, por menjëherë ishte shkëmbyer te Dallas Mavericks dhe më pas ka rikthyer

karrierën në ligat më të ulëta. Më 19 gusht 2025 Podkolzin ka filluar për Amkal Moscow kundër Kalugas në Rrethin e 2-të të Kupës së Rusisë 2025/26, duke treguar se prania e tij në fushë ishte mbresëlënëse. Si sulmues qendror, ai shpesh priste topat në ajër dhe kishte



mundësi ta shënonte golin e parë për ekipin, por nuk ka arritur ta finalizonte momentin.



KOLEGJI - COLLEGE

BIZNESI

Prishtinë

Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjibiznesi.com,

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878 info@kolegjibiznesi.com

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë dhe Dega në Prizren:

Kolegji Biznesi shpall konkursin publik të rregullt për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2025/2026, në të gjitha programet e studimit të akredituara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe të licencuara nga MASHT.

Të drejtë aplikimi dhe regjistrimi në studimet themelore (Bachelor) e kanë të gjithë kandidatët që e kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë dhe që e kanë përfunduar me sukses testin kombëtar të maturës. Kurse ne studimet Master kanë të drejtë aplikimi dhe regjistrimi të gjithë kandidatët që i kanë përfunduar Studimet Bachelor.

Studime Bachelor
1.Banka dhe Financa në Biznes (Ba) - (3 Vjeçar)
2.Menaxhment dhe Ekonomiks (Ba) - (3 Vjeçar)
3.Menaxhimi i Emergjencave (Ba) - (3 Vjeçar)
4.Juridik / LLB - (4 Vjeçar)
5. Shkenca Kompjuterike Bsc - (3 Vjeçar)

Studime Master
1.Menaxhment dhe Financa – MA-(2 Vjeçar)
2.Menaxhimi i Emergjencave – MA-(2 Vjeçar)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Bachelor, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Certifikata e maturës shtetërore – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Diploma e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Dëftesat e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
- Ekstrakti i lindjes;
- Kopje e letërnjoftimit;
- 2 fotografi (formati pasaportë)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Master, i bashkëngjisin aplikacionit:

- Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar)
- CV
- Certifikatën e lindjes
- Kopjen e letërnjoftimit
- Dy foto

038/045- 500 878 : 029-230-555

044/ 049/ 048- 500 – 878



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar

Agencija za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom

Agency for Administration of Sequestrated and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 22.08.2025

Referenca: AAPSK – 012/2025

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/ copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	Daimler Benz 124, viti i prodhimit 1985, dizel, ngjyrë hiri metalike-me targa vendore-Rishpallje	1 copë	675.00€		
2	Daimler Chrysler 210 E 200 CDI Clasik,automatik.dizel, viti i prodhimit 1999, ngjyrë e kaltër e mbylltë metalike-me targa vendore -Rishpallje	1 copë	1,500.00€		
3	Ford Mondeo,B 5Y ngjyrë hiri metalike, viti i prodhimit 2003, dizel-për skrap-Rivshpallje;	1 copë/ për skrap	260.47€		
4	VWGolf II,ngjyrë e bardhë,viti i prodhimit 1985, benzin-për pjesë	1 copë/ për pjesë	250.00€		
5	Audi 89, ngjyrë e kuqe- për pjesë	1 copë/ për pjesë	250.00€		
6	VW Golf II, ngjyrë e kuqe,viti i prodhimit 1984,-me targa vendore	1 copë	250.00€		
7	Suzuki Vitara, ngjyrë e bardhë,viti i prodhimit 1990 -me targa vendore	1 copë	950.00€		
8	Motoçikletë Yamaha JFM 450 FX, ngjyrë e zezë,viti i prodhimit 2008 -për pjesë	1 copë/ për pjesë	80.00€		
9	Opel Astra 1.9 CDTI, ngjyre e bardhë, dizel,viti i prodhimit 2010--me targa vendore	1 copë	4,500.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri m.28.08.2025 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë.

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 28.08.2025, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë,`

Pasurit e sekuestruar ose te konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aapsk.rks-gov.net> apo <https://md.rks-gov.net/>.

Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254



KOLEGJI - COLLEGE

BIZNESI

Prishtinë

Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjibiznesi.com, info@kolegjibiznesi.com

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë:

SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK

I. PROFESORA

1. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Ekonomik,**
2. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Juridik,**
3. **Dy (2)** mësimdhënës në programin - **Menaxhimi i Emergjencave,**
4. **Një (1)** mësimdhënës në programin – **Shkenca Kompjuterike,**

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Kolegjit Biznesi.

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **18.06.2025 deri më 30.06.2025.**

Paraqitja e dokumenteve: Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: info@kolegjibiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegjibiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: www.kolegjibiznesi.com ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Urata Tahiri shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr .Unik Identifikues: 810063016 në Prizren.

- Qlirim Xhimshiti shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m. të vitit të I.II. III si dhe dëftesën e shkollës fillore “Ilmi Bahtjari” KK Dragash.

Besian Binaku shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Mirlinda Veseli shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Sulejman Vokshi” Smolic Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Faik Puka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Ali Hasi” Cërmjan Gjakovë, nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpazj. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Ermbotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

